

Gjykata Supreme e Kosovës
PZD-KZU Nr. 77/10
Prishtinë
28 shtator 2010

Kolegji i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga:

KRYETARI I KOLEGJIT
Gerrit-Marc Sprenger, Gjyqtar i EULEX-it

ANËTARËT E KOLEGJIT
Lars Dahlstedt, Gjyqtar i EULEX-it
Emine Mustafa, Gjyqtare e Gjykatës Supreme
Nesrin Lusha, Gjyqtare e Gjykatës Supreme
Marije Ademi, Gjyqtare e Gjykatës Supreme

PROCESMBAJTËS
Andrea Chmieliński Bigazzi
Zyrtar Ligjor i EULEX-it

Në lëndën penale kundër **Qahil Shabanit**, [redacted]
[redacted], Komuna Viti, Shqiptar i Kosovës, mashkull, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i 3 fëmijëve, i dënuar nga gjykata Zvicerane për vepra penale të lidhura me narkotikë (neni 19, paragrafi 1 i Aktit Zviceran për Narkotikë) dhe Posedim të Armëve të Zjarrit të kryer në Zvicër. Përfundimisht i dënuar nga Gjykata Supreme e Kantonit të Luzernit, Zvicër, me 7 vjet burgim më 13 korrik 1999, pas qëndrimit në paraburgim që nga data 01 mars 1997. I arratisur nga qendra e paraburgimit në Zvicër më 03 prill 2000. I arrestuar në Prishtinë, Kosovë, më 12 prill 2007, dhe i mbajtur në paraburgim që prej asaj kohe. Është urdhëruar të vuajë dënimin Zviceran të lartpërmendur në Kosovë, me vendim të Gjykatës së Qarkut në Gjilan të datës 11 qershor 2007 (PP Nr. 76/07). Tani në vuajtje të dënimit me burgim në qendrën e paraburgimit të Dubravës, Komuna Istog në Kosovë.

Duke vendosur mbi kërkesën e të pandehurit [redacted] për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit (neni 448 i KPPK-së) të paraqitur përmes Avokatit të tij mbrojtës [redacted], në bazë së cilës i pandehuri kërkon të ndryshohet aktgjykimi i formës së prerë i Gjykatës së Qarkut në Gjilan të datës 11 qershor 2007 (PP Ne. 76/07) dhe të lirohet për t'ju nënshtruar [redacted] gjatë qëndrimit në shtëpi. Në veçanti, për shkak të [redacted] të përcaktuar nga një [redacted] të pretenduar për [redacted] (ex parte certifikatat [redacted] janë të përfshira në kërkesë), i pandehuri paraqet kërkesën e tij pasi që [redacted] e pretenduar e tij do të përcaktonte një rrethanë që nuk ekzistonte kur ishte marrë aktgjykimi dhe që qartazi do të kishte qar drejt një dënimi më të butë; po ashtu duke konstatuar se [redacted] e të pandehurit [redacted]

Lëshon këtë

AKTVENDIM

Kërkesa e paraqitur nga avokati mbrojtës [redacted] në emër të të pandehurit [redacted] për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit **REFUZOHET**.

ARSYETIMI

Historia e Procedurës

I pandehuri është dënuar përfundimisht nga Gjykata Supreme e Kantonit të Luzernit, Zvicër, me 7 vjet burgim më 13 korrik 1999, pas qëndrimit në paraburgim që nga data 01 mars 1997. KA ikur nga qendra e paraburgimit në Zvicër më 03 prill 2000.

Më 14 mars 2007, Zyra Federale Ekzaminuese e Magjistratit në Zvicër lëshoi një urdhër arrest kundër të pandehurit lidhur me krimet tjera për të cilat ishte i akuzuar, përveç dënimit të ciklin ishte duke e vuajtur. [REDAKTUAR] u arrestua në Prishtinë, Kosovë, më 12 prill 2007, dhe që atëherë mbahet në paraburgim. Më 10 korrik 2007, organet Zvicerane paraqitën një kërkesë që dënimi i Gjykatës Supreme të Kantonit të Luzernit i datës 13 korrik 1999 të ekzekutohet në Kosovë në përputhje me nenin 510, paragrafin 1 të KPPK-së.

Kërkesa është pranuar dhe i pandehuri është urdhëruar të vuajë dënimin Zviceran të lartpërmendur në Kosovë, me vendim të Gjykatës së Qarkut në Gjilan të datës 11 qershor 2007 (PP Nr. 76/07). [REDAKTUAR] tani është duke vuajtur dënimin me burgim në qendrën e paraburgimit të Dubravës, Komuna Istog në Kosovë.

Më 14 maj 2010, i pandehuri [REDAKTUAR] paraqiti një kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit përmes avokatit të tij mbrojtës [REDAKTUAR] (neni 448 i KPPK-së) në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Gjilan. I pandehuri kërkon të ndryshohet aktgjykimi i formës së prerë i Gjykatës së Qarkut në Gjilan i datës 11 qershor 2007 (PP Nr. 76/07), dhe të lirohet për t'ju nënshtruar një [REDAKTUAR] duke qëndruar në shtëpi.

Posaçërisht, për shkak të [REDAKTUAR] të pohuar me [REDAKTUAR] (ex parte [REDAKTUAR] të përfshira në kërkesë), i pandehuri dorëzon kërkesën e tij pasi që sëmundja e tij e pohuar do të përcakton një rrethanë e cila nuk ka ekzistuar në kohën kur është lëshuar aktgjykimi dhe e cila në mënyrë të qartë do të shpinte në një dënim më pak të ashpër; gjithashtu duke thënë [REDAKTUAR]

Zyra e Prokurorit Publik të Qarkut në Gjilan, më 15 qershor 2010 ka propozuar që Gjykata e Qarkut në Gjilan të refuzojë kërkesën e të pandehurit si të pabazuar pasi që ka mungesë të vërtetimeve [REDAKTUAR] nga Instituti i Mjekësisë Ligjore në Prishtinë të cilat do t'i mbështesnin raportet [REDAKTUAR]

Gjykata e Qarkut në Gjilan në Rekomandimin e saj të datës 17 qershor 2010 (PP Nr 76/07), të dorëzuar sipas nenit 450 të KPPK-së, rekomandon pranimin e kërkesës së të pandehurit “në një pjesë e cila duhet të definohet – ose madje që përputhet – me periudhën e plotë të mbetur akoma për tu vuajtur”.

Zyra e Prokurorit të Shtetit në parashtresën dhe propozimin e saj, të datës 02 gusht 2010 (KZJD Nr. 77/10), të dorëzuar sipas nenit 450 të KPPK-së, propozon refuzimin e kërkesës së të pandehurit ose “si alternativë të ketë një përcaktim mjekësor të duhur të bërë nga ana e Institucionit profesional sipas nenit 176 të KPPK-së, para se Gjykata Supreme të lëshoj vendimin e saj”

Kolegji për lirim me kusht së fundi ka refuzuar kërkesën e të pandehurit për lirim më 4 gusht 2010 (CRP.Nr. 364/08).

Gjetjet e Gjykatës

Kjo Gjykatë konsideron se vërtetimet [redacted] të paraqitura deri më tani nga pandehuri dhe avokati i tij mbrojtës janë vetëm vërtetime *ex parte* dhe nuk janë plotësisht të kënaqshme lidhur me detajet e [redacted] së pohuar dhe [redacted]. Raporti i Kryesuesit të [redacted] i datës 21 prill 2010, thotë vetëm se [redacted]. Ky rresht i shkurtër nuk konsiderohet se i ofron minimumin dhe nivelin e kënaqshëm të informacioneve kësaj Gjykate për të vendosur. Në fakt, nuk cek se çfarë lloji të [redacted] lidhur me përcaktimin e [redacted]. Nuk përmend nëse dhe deri në çfarë shkalle i pandehuri ka nevojë për [redacted] dhe nëse ky [redacted] mund të ofrohet në [redacted]. Përfundimisht nuk e qartëson llojin e “*ndihmës*” për të cilën i pandehuri ka nevojë dhe në anën tjetër llojin e “*ndihmës*” të cilën burgu nuk mund t’ia ofroj të pandehurit.

Në përgjithësi, autoritetet [redacted] zyrtare të Shërbimit Korrektues të Kosovës në njërin anë dhe vërtetimet *ex parte* të dorëzuara nga i pandehuri në anën tjetër, nuk i ofrojnë kësaj Gjykate indikacione të mjaftueshme që [redacted] e të pandehurit paraqet bazë për ta marrë në konsideratë kërkesën për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit.

Përveç kësaj, duhet pasur parasysh që sipas nenit 450, paragrafit 4 të KPPK-së, Gjykata Supreme nuk është në gjendje të mbledh dokumentacione shtesë, e cila në të kundërtën është nën kompetenca të gjykatës së shkallës së parë. Rrjedhimisht, propozimi i Prokurorit të ZPSHK-së për sigurimin e vërtetimeve [redacted] shtesë lidhur me gjendjen e të pandehurit nuk mund të merret në konsideratë.

Duke e pasur parasysh atë që u tha më lart, kjo Gjykatë beson se kërkesa e të pandehurit nuk ka vërtetuar se ekzistojnë bazat ligjore për pranimin e kërkesës siç është përcaktuar me nenin 450, paragrafin 6 të KPPK-së. Në të vërtetë, madje duke e marrë parasysh Rekomandimin e Gjykatës së Qarkut në Gjilan, të datës 17 qershor 2010, mund të argumentohet se “*rrethanave*” të referuara në nenin 448 të KPPK-së lidhur me rrethanat lehtësuese dhe elementet siç i referohen në nenin 64, dhe sipas Kodit Penal të Kosovës i cili i referohet “*rrethanave*” që kanë ekzistuar në momentin e kryerjes së krimit siç janë përcaktuar, konsideruar dhe vlerësuar në momentin e lëshimit të aktgjykimit në lidhje me kryerjen e krimit. Përfundimisht, “*rrethanat*” e reja si ndryshimi i gjendjes [redacted] së të pandehurit gjatë dorëzimit të aktgjykimit të formës së prerë të shqiptuar ndaj tij, rregullohen me anë të rregullave tjera të aplikueshme në Kosovë. Në këtë rast, mund t’i referohemi nenit 100 të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale.

Kjo Gjykatë përkujton se ky refuzim nuk e pengon të pandehurin që të paraqes një kërkesë më të vërtetuar dhe më të bazuar.

Prandaj, është urdhëruar si në dispozitiv.

Anëtarët e kolegjit:

Lars Dahlstedt
Gjyqtar i EULEX-it

Emine Mustafa
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Nesrin Lushta
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Marije Ademi
Gjyqtare e Gjykatës Supreme

Krvetar e kolegjit:

Procesmbajtës:

Gerrit-Marc Sprenger
Gjyqtar i EULEX-it

Andrea Chmieliński Bigazzi
Zyrtar Ligjor i EULEX-it

Këshillë juridike

Ankesa kundër këtij Aktvendimi nuk është e mundur.